



Drejtoresha Ekzekutive e AKD-së znj. Sonila Hysi priti sot në takim Konsullin e Nderit të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, Z. Shahin Omarov



Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës znj. Sonila Hysi priti sot në takim Konsullin e Nderit të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, Z. Shahin Omarov ku u diskutua për një sërë nismash të përbashkëta në mbështetje të komunitetit shqiptar në Ukrainë.

Në takim u bisedua për projektet e përbashkëta me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, për rëndësinë e diasporës shqiptare në Ukrainë, si dhe vijësinë e bashkëpunimit mes të dy palëve. Gjithashtu u fol për projektin e vendosjes së bustit të Nënë Terezës pranë shqiptarëve në Ukrainë, një nismë e cila dëshmon vullnetin e Shqipërisë dhe shtetit pritës Ukrainës për forcimin e marrëdhënieve të komunitetit shqiptar me vendin e tyre të origjinës.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

KKD, SHBA/ Komuniteti Shqiptar në New York, protestë para konsullatës së Serbisë: "Marsh për drejtësinë e saj"

Me moton "Marsh për Drejtësinë e Saj", komuniteti shqiptar në Nju Jork së bashku me komunitetin kroat dhe atë boshnjak ka protestuar para Konsullatës së Serbisë në Nju Jork me kërkesën që shteti serb të mbajë përgjegjësi për krimet e dhunës seksuale gjatë luftërave të viteve '90 në Ballkan. Protestuesit kërkojnë drejtësi për mijëra viktime të dhunës seksuale gjatë luftës.

Protestën e kanë përkrahur edhe shumë lider të komunitetit, aktivistë të dalluar, dhe personalitete të njohura të politikës, pjesëtarë të shoqërisë civile, shkrimtarë, sportistë e artistë të fushave të ndryshme, biznesmenë e filantropist, si edhe Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e Hapur", etj.

Këtë protestë, e cila zgjati më shumë se dy orë e drejtoi Këshilltari shqiptar i Nju Jork-ut, z. Mark Gjonaj.



Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme

KKD, SHBA/ Beteja për drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale në Ballkan



Në qytetin e Nju Jork-ut, komuniteti shqiptar, kroat dhe boshnjak në Shtetet e Bashkuara mbajti të enjten një protestë para Konsullatës së Serbisë, me kërkesën që shteti serb të mbajë përgjegjësi për krimet e dhunës seksuale gjatë luftërave të viteve '90 në Ballkan. Protestuesit kërkojnë drejtësi për mijëra viktime të dhunës seksuale gjatë luftës.

Njëra nga të mbijetuarat e përdhunimit, Vasfije Krasniqi-Goodman, ishte të mërkurën në Uashington për të kërkuar mbështetjen e Kongresit amerikan në betejën e saj për drejtësi. Pjesë e grupit të komunitetit shqiptaro-amerikan në takimet në Uashington ishte edhe anëtari i Këshillit Bashkiak të qytetit të Nju Jork-ut, z. Mark Gjonaj. Ai tha se është e domosdoshme që takimet informuese të jenë të vazhdueshme që përmes përfshirjes amerikane të ruhet qëndrueshmëria në Ballkan.



CONNECT ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës pjesë e konferencës "Migrimi, Diaspora dhe Zhvillimi në Shqipëri e në Ballkanin Perëndimor"

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës pjesë e konferencës "Migrimi, Diaspora dhe Zhvillimi në Shqipëri e në Ballkanin Perëndimor", organizuar nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale (CESS) dhe mbështetet financiarisht nga Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) dhe Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI).

Në këtë takim të përvitshëm do të diskutohen tema dhe çështje të fokusuara në kërkimin dhe politikën e migracionit. Për më tepër, ai synon të sfidojë modelet dhe diskursin ekzistues të migracionit, të adresojë sfidat aktuale të politikave dhe të ofrojë zgjidhje për shfrytëzim më të mirë të lëvizshmërisë njerëzore.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë



Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta
"Diaspora Shqiptare"

SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.



Digitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen